

## KONTRATË DHE STATUT

### ***Për krijimin e shoqërisë "ENA Consultancy Ltd" shpk.***

Z. Angjello Andoni i datëlindjes 08.01.1947 lindur në Vuno dhe banues në Gjirokastrë, në Rrugën 18 Shtatori me ID: E70108011A, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar,

i quajtur më poshtë Ortaku

vendosi sot në datën 10.08.2023 të krijojë shoqërinë "ENA Consultancy Ltd" shpk me qendër në Gjirokastrë, Shqipëri me kontratën dhe statutin e mëposhtëm:

#### **1. Firma dhe Selia**

- 1) Firma e shoqërisë do të quhet "ENA Consultancy Ltd" shpk;
- 2) Ortak i vetëm i shoqërisë është z. Angjello Andoni;
- 3) Shoqëria e ka selinë e saj në Gjirokastrë në Rrugën 18 Shtatori, Nd. 2.
- 4) Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda apo jashtë vendit.

#### **2. Objekti i shoqërisë**

Objekti i shoqërisë është aktiviteti i konsulencës në fushën ligjore.

#### **3. Kohëzgjatja e shoqërisë**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është pa afat.

#### **4. Kapitali i Shoqërisë**

- 1) Kapitali i shoqërisë është në shumën 100,000 lekë i përbërë nga 1 kuotë me vlerë nominale 100,000 lekë që zotërohen 100% nga ortaku i vetëm Angjello Andoni.
- 2) Shoqëria "ENA Consultancy Ltd" shpk nuk mund të ofrojë kapitalin si mjet investimi për publikun e gjerë.
- 3) Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej saj mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) Shitblerjes;
  - c) Trashëgimisë;
  - d) Dhurimit;
  - e) Cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
- 4) Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë kontrata duhet të bëhet me shkrim.

#### **5. Drejtimi i shoqërisë**

##### 5.1 Administratori

- 1) Shoqëria ka një administrator. Nëse shoqëria ka emëruar një administrator ky është përfaqësuesi i vetëm i shoqërisë. Administrator i shoqërisë për një periudhë prej tre vjetësh

është z. Erion Andoni i datëlindjes 10.08.1977, lindur e banues në Gjirokastrë, me ID: H70810079C, madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

- 2) Administratori i nënshtrohet detyrimit të besnikërisë, heshtjes, informimit dhe bindjes. Gjatë ushtrimit të detyrave ai duhet të marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakut.
- 3) Administratori, kohëzgjatja dhe kompetencat e përfaqësimit caktohen me vendim të Asamblesë së përgjithshme të shoqërisë. Administrimi mundet ti caktohet nëpërmjet një kontrate administrimi edhe një avokati ose një subjekti të përshtatshëm. Ky vepron si administrator i shoqërisë.
- 4) Detyra e Administratorit të shoqërisë do të jetë pa shpërblim.

## 5.2 Asambleja e përgjithshme

- 1) Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë në çështjet e mëposhtme:
  - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) Ndryshimet e statutit;
  - c) Emërimin e shkarkimin e administratorit dhe kompetencat e tij;
  - d) Emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) Përcaktimin e shpërblimit për administratorin dhe personat e përmendur në shkronjat "d" të kësaj pike;
  - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - h) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - i) Çështje të tjera të përcaktuara nga ligji apo statuti.
- 2) Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme për shoqërinë "ENA Consultancy Ltd" shpk ushtrohet nga ortaku i shoqërisë.

## 6. Prishja e shoqërisë

Shoqëria "ENA Consultancy Ltd" shpk priset:

- a) Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- b) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) Për arsye të tjera të parashikuara në ligj.

Ortaku i shoqërisë "ENA Consultancy Ltd" shpk

Angjello Andoni

Gjirokastrë më 10.08.2023